



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 182, datë 30.3.2022

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT,
PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT
TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA
TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 3.1, të vendimit nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.2, me këtë përmbajtje:

"3.2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2022, të jetë në masën 605 498 838 (gjashtëqind e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë".

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1711/1
DATË 30.3 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', written in a cursive style.